



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____/____/2022

V E N D I M

Nr. 100, Datë 23/05/2022

Mbështetur në ligjin nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 21, datë 01.02.2022, e Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, ku pretendohet diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të “racës”, të pakicës kombëtare romë, nga ana e opinionistit A.M., në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga z. A.D., në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se në datën 21.01.2022, në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga z. A.D., në Televizionin Vizion Plus, gjatë diskutimeve të zhvilluara në studio, në minutën 75 opinionisti A.M. ka përdorur shprehjen “*si arrixhinjtë në rrugë me trastën në kurriç*” duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Subjekti ankues pretendon se shprehja e përdorur nga opinionisti A.M. është mbështetur nga kolegët pjesëmarrës në diskutim, sikurse dhe nga redaksia e emisionit, e cila nuk ka reaguar, por përkundrazi e ka mbështetur duke i vënë titullin “*Spotlight - Shpërthen A.M.: Grupi i Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, lajmit të hedhur në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>.

Rrjeti i Organizatave R/E në qytetin e Korçës shprehin indinjatën e thellë për këtë shprehje të përdorur nga opinionisti A.M., pasi dëmton imazhin e komunitetit rom dhe e diskriminon hapur këtë pakicë kombëtare. Subjekti ankues pretendon se opinionisti ka përdorur gjuhë urrejtje ndaj kësaj pakice kombëtare dhe kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të racës, të komunitetit rom.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të racës, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 21, datë 01.02.2022, së Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Televizionit Vizion Plus dhe opinionistit A.M., si dhe për dijeni Rrjetit të Organizatave R/E, me shkresën nr. 222/1, datë 09.02.2022, ku kërkohej informacion mbi situatën e parashtruar nga subjekti ankues.
- Zarfë me shkresën e sipërcituar drejtuar z. A.M., e cila ishte dërguar në adresën e Televizionit Vizion Plus, u kthye mbrapsht me shënimin “larguar”;
 - Në vijim, në datën 24.02.2022, KMD iu drejtua nëpërmjet e-mailit zyrtar Televizionit Vizion Plus, ku i kërkoi adresën e e-mailit ose një numër kontakti me të, me qëllim mbajtjen e korrespondencës zyrtare me të në kuadër të shqyrtimit të ankesës.
 - Televizioni Vizion Plus nuk i ktheu përgjigje as shkresës nr. 222/1 prot., datë 09.02.2022, së Komisionerit dhe as e-mailit ku kërkohejshin kontaktet e opinionistit;
 - Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua sërish subjekteve me shkresën nr. 222/2 prot, datë 04.03.2022, ku u bëhej kujtesë për kthim përgjigje dhe për dhënie informacioni në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 21, datë 01.02.2022, së Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë. Nëpërmjet kësaj shkrese, KMD iu kërkoi sërish zyrtarisht Televizionit Vizion Plus, kontakte për të komunikuar me z. A.M..
 - Televizioni Vizion Plus nuk i ktheu përgjigje shkresës nr. 222/2 prot, datë 04.03.2022, të KMD-së;

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Zarfi me shkresën nr. 222/2 prot, datë 04.03.2022, drejtuar z. A.M., dërguar në adresën e TV Vizion Plus, u kthye sërish mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin “adresë e pamjaftueshme”.
- Mbështetur në nenin 162, të Kodit të Procedurave Administrative³, në kushtet kur, adresa e z. A.M. ishte e panjohur dhe Televizioni Vizion Plus refuzoi të informonte KMD-në mbi të dhënat e kontaktit (e-mail, nr. telefoni) të z. A.M., KMD shpalli Njoftimin Publik nr. 709 Prot., datë 04.05.2022, për z. A.M., nëpërmjet së cilit ai njoftohet zyrtarisht dhe publikisht mbi procedurën administrative të Komisionerit mbi bazën e ankesës nr. 21, datë 01.02.2022. Bashkëlidhur Njoftimit Publik u publikuan edhe shkresa nr. 222/1, datë 09.02.2022 dhe shkresa nr. 222/2 prot, datë 04.03.2022, e KMD-së drejtuar z. A.M., të kthyer mbrapsht nga shërbimi postar. Njoftimi publik u shpall në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe u afishua edhe në këndin e njoftimeve të godinës, ku KMD ushtron aktivitetin e tij.

Në kushtet kur, pas kalimit të afatit ligjor 10 ditor të përcaktuar në nenin 162, të Kodit të Procedurave Administrative, nga ana e z. A.M. nuk pati asnjë reagim zyrtar, Komisioneri procedoi në vijimësi me shqyrtimin e ankesës nr. 21, datë 01.02.2022.

Në kushtet kur, Televizioni Vizion Plus refuzoi të bashkëpunojë me Komisionerin, duke mos dërguar prapësimet e tij, lidhur me çështjen objekt ankese edhe pse ka marrë dijeni mbi shkresat e tij, Komisioneri vazhdoi trajtimin e ankesës në bazë të provave të depozituara nga subjekti ankues.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

³ Neni 162, pikat 1-3, të Kodit të Procedurave Administrative parashikojnë shprehimisht: 1. Njoftimi publik bëhet në këto raste: a) kur palët janë të panjohura; b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur; ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. 2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet. 3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.....”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjithkush është i ndërgjegjshëm mbi faktin se liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të përcaktueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkëekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përçmimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për genocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, femoneme të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo pakica kombëtare, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë nga të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

KEDNJ është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Europës për vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Për sa më sipër, në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës së si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku⁴:

1. ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. ndërhyrja ka si qëllim të mbrojë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

⁴ Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane – Liria e Shprehjes;

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “*nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....*”⁵ Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” kundrejt lirisë për të dhënë dhe marrë informacion u shqyrtua gjithashtu nga GJEDNJ në çështjen *Jersild kundër Danimarkës (1994)*, në kontekstin e disa deklaratave raciale të shfaqura në televizion me qëllimin e thjeshtë për të informuar publikun rreth individëve që mbajtën një fjalim racial. GJEDNJ u shpreh mbi rëndësinë jetësore të luftës kundër diskriminimit racial në të gjitha format e tij në mediat televizive.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se liria e shprehjes, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cënojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁶ ku parashikohet shprehimisht: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”. Megjithatë, Komisioneri thekson sërish faktin se liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve. Në bazë të nenit 17, Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Parashikimi i saj sqaron se: “*Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Në këtë kontekst, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që:

Në datën 21.01.2022, në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga z. A.D., në Televizionin Vizion Plus, gjatë diskutimeve të zhvilluara në studio, në minutën 75, opinionisti A.M. ka përdorur shprehjen “*si arrihinjtë në rrugë me trastën në kurriz*” duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Emisioni i sipërcituar është publikuar nga ana e TV

⁵ Për më shumë informacion referoju çështjes *Engels and Others kundër Hollandës*, 1976.

⁶ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”;

Vizion Plus në faqen *Youtube* me titullin “*Spotlight - Shpërthen A.M.: Grupi i Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>.

- Pavarësisht, kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar TV Vizion Plus, ku iu kërkuar në mënyrë të përsëritur për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e këtij subjekti nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument, lidhur me shprehjen e përdorur në emisionin e tij “Spot LIGHT”, në adresë të komunitetit rom, si dhe për titullin që i është vënë këtij emisioni në publikimin e bërë në faqen *Youtube*.

Në këto kushte, Komisioneri u mbështet pikërisht në publikimin e bërë nga ky televizion, në në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>, të emisionit të sipërcituar. Nga verifikimi i drejtpërdrejtë rezultoi se në minutën 75, të këtij emisioni, z. A.M. ka përdorur shprehjen “*si arrixhinjtë në rrugë me trastën në kurriz*” duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Në vijim të këtij emisioni, Komisioneri ka konstatuar se nuk ka patur asnjë reagim zyrtar të këtij televizioni, ku të jetë mbajtur qëndrim ndaj shprehjes së përdorur nga z. A.M., por përkundrazi Komisioneri vuri re se ky televizion e ka titulluar emisionin e publikuar në internet me titullin “*Spotlight - Shpërthen A.M.: Grupi i Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, duke e ritheksuar dhe përforcuar shprehjen e përdorur nga opinionisti, në titullin e emisionit.

Emisioni kishte si objekt diskutimi çështjen e grupimit të formuar brenda një subjekti të caktuar politik, ku z. A.M. mbajti qëndrim kundërshtues lidhur me mënyrën se si po vepron ky grupim. Në këtë kontekst, është mëse e evidente që konotacioni i shprehjes së përdorur më lart nga ana e tij ka qenë negativ.

Shprehja e përdorur, në Emisionin “Spot LIGHT”, të datës 21.01.2022, nga opinionisti A.M. paraqet rëndësi të veçantë, pasi është përdorur në një televizion privat kombëtar si TV Vizion Plus dhe në kushtet kur shikueshmëria e këtij emisioni nga publiku është e konsiderueshme. Pavarësisht, se shprehja është përdorur nga një opinionist i ftuar nga ky televizion dhe përgjegjësia për gjuhën e përdorur është personale, Komisioneri gjykon se përgjegjësia më e madhe është e vetë televizionit, që duhet të mbante një qëndrim kritik të vijim të përdorimit të kësaj shprehjeje në një emision të tij. Ky qëndrim, jo vetëm nuk është mbajtur nga ana e TV Vizion Plus, por për më tepër është bërë një “reklamim” dhe përforcim i shprehjes së përdorur nga z. A.M., duke e vënë si titull të emisionit të hedhur në *Youtube* nga ky televizion. Emisioni në fjalë është publik dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen *youtube*, duke bërë të mundur që jehona e shprehjes së përdorur të ketë një përhapje të gjerë në opinionin publik. Lidhur me sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar komente indinjuese të personave të tjerë, lidhur me këtë titull dhe shprehjen e përdorur nga opinionisti.

Për sa më sipër, termi *arixhi*⁷ është një nga mënyrat se si komuniteti rom identifikohet në zona të ndryshme të Shqipërisë. Përdorimi i këtij termi përmban një konotacion negativ, përçmues dhe denigrues kundrejt komunitetit rom, duke shfaqur doza diskriminimi dhe përforcon stereotype kundrejtë këtij komuniteti. Referuar rastit në fjalë, z. A.M. i referohet grupimit, brenda subjektit të caktuar politik se “*bredhin rrugëve si arixhinjtë*”, duke i vendosur anëtarët e komunitetit rom në pozita inferiore dhe denigruese. Në këtë kuptim, përdorimi i zhargonit të vjetër popullor, nga z. A.M., përforcon stereotipet e krijuara ndaj pakicës kombëtare rome dhe i vendos ata në pozita të pafavorshme e përçmuese në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Në këtë kontekst, KMD vë në dukje faktin se ligji Nr. 96/2017 “*Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë*”, njeh komunitetin rom në Shqipëri si pakicë kombëtare dhe garanton mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit⁸.

Në analizën që KMD i ka bërë gjuhës së përdorur në Emisionin *Spot Light*, ka vlerësuar se përdorimi i saj konsiderohet në tejkallim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë kontekst, KMD i është referuar kufizimeve që parashikon KEDNJ për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në gjykime të ndryshme se: “*Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)*”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

⁷ Në fjalorin e Gjuhës Shqipe ky term përdoret si: [Cigan endacak](#).

⁸ Neni 2 “1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. 2. Në ushtrimin e këtyre të drejtave, personat që u përkasin pakicave kombëtare duhet të respektojnë shtetin ligjor, tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.” dhe 3 “1. Pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 2. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare”.

Përveç sa më sipër, KMD gjykon se për rastin konkret është me vend të përmendet edhe Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015, i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, i cili është një akt shumë i rëndësishëm, që u drejtohet qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe që fokusohet në fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të saj për individët, grupe të caktuara personash dhe shoqërinë në tërësi.

Gjuha e urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes - përkatësisht, avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshtruese të karakteristikave personale apo statusit që përfshin “racën”, ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose prejardhjen kombëtare apo etnike, si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Në këtë Rekomandim, elementët domethënës të konceptit “gjuhë urrejtje”, lidhen me:

- avokimin, promovimin apo nxitjen e çfarëdo forme denigrimi, urrejtjeje apo përgojimi, si edhe ngacmimin, fyerjen, stereotipizimin negativ, stigmatizimin apo kërcënimin;
- përdorimin që synon jo thjesht të nxitë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte; dhe,
- shkaqet që shkojnë përtej “races”, ngjyrës, gjuhës, fesë apo besimit, kombësisë, prejardhjes kombëtare apo etnike apo prejardhjes prindërore.

“Shprehja” sipas këtij Rekomandimi përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Ndërkohë që, format e shprehjes që janë në fushën e veprimit të Rekomandimit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, banalizimin, justifikimin apo legjitimimin për krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës, të cilat janë konstatuar nga gjykatat, si edhe lartësimin e personave për kryerjen e krimeve të tilla.

Nëpërmjet këtij Rekomandimi, ndër të tjera, shteteve palë u rekomandohet që *“të ofrojnë mbështetje individuale dhe kolektive për personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes ...”*⁹ si dhe *“të përdorin fuqitë rregullatorë në drejtim të medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të*

⁹ Referuar pikës 5 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes (2015)

internetit, ndërmjetësit online dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit...”¹⁰ nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në këtë akt.

Praktika e GJEDNJ-së, gjithashtu, është e pasur lidhur me vendimmarrjet mbi çështjet, ku objekt gjykimi ka qenë gjuha e urrejtjes. Në çështjet *Féret k. Belgjikës*, (2007) dhe *Vejdeland dhe Të Tjerë k. Suedisë*, (2012), GJEDNJ ka pranuar se nxitja e urrejtjes mund të rezultojë në fyerje, tallje apo shpifje ndaj grupeve të caktuara të popullsisë, kur këto forma të shprehjes ushtrohen në mënyrë të papërgjegjshme, që nënkupton se është fyese në mënyrë të panevojshme, avokon diskriminimin apo përdor gjuhë cenuese apo poshtëruese ose i imponohet publikut në mënyrë të pashmangshme dhe këto forma janë brenda fushës së veprimit të përkufizimit të Rekomandimit të sipërcituar.

Në çështjen *Garaudy kundër Francës*, (2003), GJEDNJ u mbështet në nenin 17 të KEDNJ-së dhe u shpreh se liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të çuar në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të tjera, të garantuara nga Konventa. Këto vendime zbatojnë teorinë e paradoksit të tolerancës: një tolerancë absolute mund të çojë në tolerancën e ideve që nxisin mostolerancë dhe kjo e fundit mund të asgjësojë tolerancën.¹¹

GJEDNJ ka trajtuar jo vetëm rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga subjekte të caktuara, por edhe rastet kur nga subjekte të tjera në lidhura me ta nuk është mbajtur qendrim kritik ndaj përdorimit të kësaj gjuhe. Kështu, në çështjen *Jersild kundër Danimarkës* (1994) kërkuesi ishte një gazetar televizioni, i cili u dënua nga gjykatat vendase për shkak të ndihmës dhe nxitjes së shpërndarjes së deklarimeve raciste. Ai kishte marrë iniciativën e përgatitjes së një programi në të cilin u intervistuan tre anëtarë të një grupi të rinjsh me pikëpamje raciste. Gazetari e dinte paraprakisht që mund të bëheshin deklarime raciste gjatë intervistimit dhe i kishte inkurajuar këto deklarime. Ai i përfshiu edhe deklaratimet fyese gjatë redaktimit të intervistave. Intervistat pastaj u paraqitën në një program televiziv serioz, të synuara për dëgjues të mirinformuar, që trajtonin një gamë të gjerë çështjesh sociale dhe politike, duke përfshirë ksenofobinë dhe imigrimin. Dëgjuesit mund të dëgjonin deklarime të tilla, si: “*Është mirë të jesh racist*”. “*Ne besojmë që Danimarka është për danezët*”; “*Njerëzit duhet të lejohen të mbajnë skllëvër*” etj. Arsyeja kryesore se pse gjykatat e brendshme e fajësuan gazetarin për ndihmën dhe nxitjen e thënieve raciste ishte mungesa e një deklarami përfundimtar nëpërmjet të cilit, sipas mendimit të gjykatës, ai duhej të kritikonte shprehimisht këndvështrimet raciste të shprehura gjatë intervistave.

¹⁰ Referuar pikës 7 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes (2015)

¹¹ Siniarska D.B, (2015) Manual për praktikantët e ligjit - Mbrojtja e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

Përveç sa më sipër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur në çështjen *Erbakan kundër Turqisë*, 6 korrik 2006, se, në parim, mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. Në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar 1976*, GJEDNJ është shprehur se e drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditë apo shqetësojë” të tjerët.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se “fjalimet e urrejtjes” kundër personave që i përkasin komunitetit rom, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të bëra publike nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtij komuniteti. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Komisioneri është i vetëdijshëm se, liria e fjalës në median kombëtare televizive është e një rëndësie të veçantë, por, rëndësia që merr liria e fjalës e ngarkon këtë media me një përgjegjësi akoma më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin ndaj pakicave të caktuara kombëtare. (*shih Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ*).

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen *Feryn*¹² ku është shprehur se: “...mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”. Në çështjen në fjalë, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar faktin se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste, kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë duke mos patur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standardi, të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standardi të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të LMD, të ndryshuar.

Duke iu referuar çështjes *Delfi AS kundër Estonisë*¹³, vërejmë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashtroi se: “...duhet të mbahet përgjegjësi, në parim, për gjuhë shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme dhe kjo të përbëjë mjet efektiv ndaj cënimit të personalitetit të individëve.” Këtu, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të nenit 10, të KEDNJ-së duke çmuar se bërja përgjegjëse e shoqërisë kërkuese nga gjykatat estoneze, kishte qenë një kufizim i justifikuar dhe proporcional i lirisë së shprehjes, veçanërisht sepse: komentet në fjalë kishin qenë ekstreme (anti-semitiste) dhe ishin postuar në reagim ndaj një artikulli të publikuar

¹² Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër firmës *Feryn NV*, C-54/07, 10 korrik 2008

¹³ *Delfi AS kundër Estonisë*, çështja nr. 64569/09, Vendimi datë 10.10.2013, Nota Informative 167.

nga një kërkues në portalin e lajmeve të drejtuar profesionalisht për qëllime tregtare, hapat e hedhur nga kërkuesi për heqjen e komenteve fyese pa vonesë pas publikimit të tyre kishin qenë të pamjaftueshme, etj.

Në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, GJEDNJ-ja mban qëndrimin se, në disa raste ndërhyrja në lirinë e shprehjes është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 3, pika 1 të LMD, të ndryshuar, “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 3, pika 8, të LMD, të ndryshuar, “gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit nëse shprehja e përdorur nga ana e z. A.M., në emisionin *Spot LIGHT*, mund të mos ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes apo diskriminimit e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, të gjithë anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Për sa më sipër, Komisioneri thekson faktin se Televizioni Vizion Plus ka përforcuar dhe vijimësuar diskriminimin, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes së pakicës kombëtare rome, duke mosmbajtur një qëndrim kritik ndaj përdorimit të shprehjes së opinionistit, as gjatë emisionit dhe as në vijim të tij, për t’u distancuar nga sa më sipër. Përpos kësaj, ky televizion ka përforcuar diskriminimin ndaj këtij komuniteti, duke publikuar në faqen Youtube, emisionin *Spot LIGHT* dhe duke i vënë si titull shprehjen e përdorur nga ana e z. A.M.. Pozita e këtij subjekti rëndohet gjithashtu, pasi ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionerin, duke mos dhënë prapësimet e tij lidhur me sa më sipër, në kushtet kur në bazë të nenit 82, pika 2

të Kodit të Procedurave Administrative¹⁴ dhe nenit 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar¹⁵, ka patur barrën e provës në këtë proces hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, pikat 2 e 8, nenin 7, pikat 1 e 3, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e z. A.M. si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emisionin *Spot LIGHT*, të datës 21.01.2022, në televizionin Vizion Plus.
2. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e Televizionit Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. A.M. në emisionin *Spot LIGHT*, për mosdistancimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në titullin e emisionit *Spot LIGHT*, të publikuar në faqen www.youtube.com.
3. Referuar pikave 1 dhe 2 të këtij Vendimi, z. A.M. dhe Televizioni Vizion Plus të shprehen me deklarata publike (verbale apo të shkruara) me anë të së cilave të kërkojnë falje ndaj pakicës kombëtare rome.
4. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Vizion Plus të marrë masa të menjëherëshme për të ndryshuar titullin e emisionit *Spot LIGHT*, të datës 21.01.2022, si dhe eliminimin/mbulimin e frazës diskriminuese të përdorur nga z. A.M. në përmbajtjen e këtij emisioni, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijani mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome.

¹⁴ Neni 82, pika 2, e KPA, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

¹⁵ Neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “*Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është ëshhtë paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*”

5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, z. A.M. dhe Televizioni Vizion Plus, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira e shërbime

Shkak – raca

Lloji i vendimit – diskriminim, në formën e gjuhës së urrejtjes

